

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT
P. Nr. 68/2000
06.03.2001

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata e Qarkut e Gjilanit, si nje gjykate e shkalles se pare, e perbere nga Patrice de Charette, kryetari i trupit gjykues, gjykatesi Hasan Sadiku, dhe ndihmes gjyqtaret Halit Gashi, Elfete Shala dhe Tefik Muji, te asistuar nga process- verbal mbajtesja Igballe Azemi, ne çeshtjen penale kunder te akuzuarit

Momçilo Trajkoviç, i biri i [REDACTED] dhe [REDACTED], mbiemri i vajzerise [REDACTED], lindur me [REDACTED] ne fshatin Carakovce, me banim te perhershem ne Kamenice, rruga [REDACTED], Serb, i martuar, baba i tre femijve, me diplome universitare, ka kryer sherbimin e rregullt ushtarak, me gjendje ekonomike te mesme, i pa gjykuar ndonjehere, ne paraburgim qe prej 07.09.1999,

Per aktet kriminale te:

- krimeve te luftes kunder popullsisë civile prej 24.03.1999 deri ne ditën e hyrjes se Forcave Nderkombetare ne Kosove, mbeshtetur ne Nenin 142 te Kodit Penal te Jugosllavise, ne perputhje me akt-akuzen e Prokurorit Publik te Gjilanit No 115/2000 te dates 21.09.2000.
- vrasjes ne tentative ne 27 Qershor 1999 ne Kamnice, mbeshtetur ne Nenin 30, par.1 i lidhur me Nenin 19 te Kodit Penal te Jugosllavise dhe mbajtjen pa leje te armeve dhe lendeve plasese ne Kamenice deri me 7 shtator 1999, mbeshtetur ne Nenin 199, par.3 ne lidhje me par.1 te Kodit Penal te Kosoves, ne perputhje me akt-akuzen e Prokurorit Publik te Gjilanit No 84/2000 te dates 3 Prill 2000.

Pas seancave publike kryesore te mbajtura me 23, 24, 27, 30 Nentor, 01, 04, 05, 06, 07, 08 Dhjetor 2000, 09, 10, 15, 26 Janar, 08, 13, Shkurt dhe 01 Mars 2001, ne presence te paleve, Zevendes Kryeprokurorit Publik te Qarkut te Gjilanit Vaxhid Idrizit, te akuzuarit si dhe te avokateve te tij mbrojtës Zhivojin Jokanoviç dhe Stoja Gjurishiç;

Job No.: *Vendimi i* Translated by: *Tritan Kalo*
M.Trajkoviçit

Phone:7616

Description: *Momcilo Trjakoviç/ Court decision*

Number of pages:

Page 1 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Dhe paleve te demtuara:

- M [redacted] R [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- I [redacted] B [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- A [redacted] B [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- H [redacted] R [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- Xh [redacted] L [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- T [redacted] I [redacted], Kamenice
- F [redacted] K [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- R [redacted] M [redacted], Rruga [redacted], Prishtine
- B [redacted] S [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- E [redacted] D [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- L [redacted] L [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- A [redacted] K [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- F [redacted] Th [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- F [redacted] S [redacted], [redacted], Prishtine
- S [redacted] I [redacted], Fshati [redacted], Prishtine
- B [redacted] K [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- M [redacted] K [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- S [redacted] D [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- H [redacted] Sh [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- Sh [redacted] B [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- H [redacted] H [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- S [redacted] S [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- Xh [redacted] R [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- R [redacted] R [redacted], Fshati [redacted], Kamenice
- M [redacted] F [redacted], Rruga [redacted], Kamenice
- G [redacted] L [redacted], Rruga [redacted], Kamenice

Ne seancen e mbajtur me 06 Mars 2001, u shpall publikisht ky

VENDIM

I akuzuari Momçilo Trajkoviç

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trjakoviç/ Court decision
Number of pages:
Last time updated: 3/15/01

Page 2 of 12
Created on 3/15/01 2:59 PM

I

ESHTE FAJTOR

Per **tentativen e vrasjes** me 27 Qershor 1999 ne Kamenice, ne perputhje me akt-akuzen e 3 Prillit 2000, sipas nenit 30 par.1 ne lidhje me nenin19 te Kodit Penal te Jugosllavise.

Arsyet:

Fakticiteti i aktit, percaktohet prej plageve te shkaktuara M■■■■ F■■■■, i cili u Mjekua ne Qendren mjeksore te Gjilanit dhe paraqiti vertetimin mjeksor perkates.

Deshmite e ketij te fundit, dhe ajo e A■■■ P■■■, pershkruajne me hollesi cfare ndolli, kur ata u qelluan prej te akuzuarit nga apartamenti i tij me nje pushke automatike, pasi ata ngriten flamurin Shqiptar ne ish godinen e Puneve te Brendshme.

Deshmia e ketij te fundit dhe ajo e shokut te tij A■■■ P■■■, u verifikuan gjate rikqyrjes se vendit te ngjarjes, ku u provua se shte e mundur te qellohet prej dritares se apartamentit te Trajkoviçit drejt viktimave te ndodhur prane gardhit te oborrit, duke u perpjekur te largoheshin pasi degjuan te akuzuarin te gerthiste.

Ato u konfirmuan prej deshmitarit Xh■■■■ K■■■■, fqi me te akuzuarin, i cili thekson se, duke qendruar ne ballkonin e tij, ne nje kat me poshte se apartamenti i te akuzuarit, ay degjoi Momçilo Trajkoviçin te therriste ne gjuhen Serbe: "Une nuk mund ta imagjinoj si eshte e mundur, qe dikush te ngrej flamurin Shqiptar ne mes te dites", dhe me pas degjoj ate te qellonte disa here.

Perballe ketyre provave, deshmiya e dhene prej te pandehurit ne lidhje me prezencen e tij ne nje pjese tjeter ne kohen e ketij incidenti, nuk mund te merret si e besueshme.

Keshtu, Momcilo Trajkovic deklarohet fajtor per kete krim, me sakesimin se te shtenat erdhen prej dritares mbi rruge dhe jo prej ballkonit.

II

ESHTE FAJTOR

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit Translated by: Tritan Kalo

Phone:7616

Description: Momcilo Trjakoviç/ Court decision

Number of pages:

Page 3 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Per mbajtjen pa leje te armeve dhe lendeve eksplozive ne Kamenice deri me 7 Shtator 1999, ne perputhje me akt-akuzen e 3 Prillit 2000, sipas nenit 199, par.1 te Kodit Penal te Kosoves.

Arsyet:

Nje pishke AK47, 300 fisheke dhe dy granada dore u zbuluan ne apartamentin e te akuzuarit prej ushtareve te KFOR-it, gjate kerkimit ne te. Shpjegimet e Moçilo Trjakoviç-it, qe theksojne se ay i gjeti ato pak me pare ne nje tjeter apartament, dera e te cilit ishte thyer, jane allogjike dhe jo bindese, mqese eshte e qarte se nje person i pa njohur, duke thyer deren mundej te kishte marre edhe keto arme dhe municione.

Per me teper, sipas deshmitarit B [REDACTED] H [REDACTED], ushtar i KFOR-it Amerikan, i akuzuari ka bere deshmi te rreme perpara kerkimit tek ay, duke thene se nuk kishte asnje arme ne apartamentin e tij, por kur filloj kerkimi, papritmas ay tha se kishte diçka per tju dhene ushtareve.

Keshtu, ka shume te dhena qe i akuzuari e ka kryer kete veprim.

III

SHKARKOHET

Ne perputhje me nenin 350 par.3 te Kodit te Procedires Penale te Jugosllavise, per krimet e meposhtme, te kualifikuara si krime lufte nga Neni 142 i Kodit Penal te Jugosllavise ne perputhje me akt-akuzen e 21 Shtatorit 2000

- Ne 1 Prill 1999, ne Kamenice, plagoset me arme zjarri R [REDACTED] R [REDACTED]. Arsyeya: R [REDACTED] ka deshmuar para gjykatsit hetues si dhe gjate gjykimit, se ai nuk eshte plagosur.
- Ne 3 Prill 1999, ne Kamenice plagosen [REDACTED] B [REDACTED] dhe A [REDACTED] B [REDACTED], me nje granade dore te hedhur ne kopeshtin e tyre. Arsyeya: viktimat nuk e kane pare autorin e krimet; nuk ka prova qe ay te jete nje akt i organizuar.
- Ne 17 Prill 1999, ne Kamenice plagosen me arme zjarri G [REDACTED] L [REDACTED] dhe V [REDACTED] S [REDACTED]. Arsyeya: nuk ka prova se ata jane plagosur.
- Ne 1 Maj 1999 ne vendin e quajtur Qafa e Kopernices, vriten E [REDACTED] J [REDACTED] dhe R [REDACTED] S [REDACTED]. Arsyeya: rrethanat ekzakte te vdekjes se R [REDACTED] S [REDACTED] jane te panjohura, ay zhduket ne nje rruge, nuk ka ndonje deshmitar ne vendngjarje. Nuk ka te dhena per vdekjen e H [REDACTED] J [REDACTED].

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trjakoviç/ Court decision

Number of pages:

Last time updated: 3/15/01

Page 4 of 12

Created on 3/15/01 2:59 PM

- Ne 11 Maj 1999, ne fshatin Hodonovc, plagosen Sh [redacted] B [redacted] dhe H [redacted] Sh [redacted], ndersa ishin duke udhtuar me maqinen e tyre. Arsyeja: nuk ka prova se ishte nje akt i organizuar.
- Ne 20 Maj 1999, ne fshatin Koretin, plagosen S [redacted] S [redacted], H [redacted] H [redacted] dhe Xh [redacted] R [redacted]. Arsyeja: nuk ka prova se ishte nje akt i organizuar.

Dhe per keto arsye te pergjithshme:

- Neni 35 i Ligjit mbi Punet e Brendeshme (Gazeta Zyrtare e Kosoves 46/1987), parasheh qe Drejtuesi i Puneve te Brendeshme eshte ne ngarkim te ceshtjeve administrative
- por:
 - = 1) Kushtetuta e Republikes Federative te Jugosllavise (neni 78, par. 3 dhe neni 99, par.1) dhe Kushtetuta e Republikes se Serbise (neni 83, par 1), shprehen per mundesine e ndryshimit te rregullave ne lidhje me punen dhe organizimin e Agjensive Shtetore dhe te Ministrive pas deklarimit te gjendjes se luftes.
 - = 2) Ligji mbi Mbrojtjen e Republikes Federative te Jugosllavise (Gazeta Zyrtare 27 Maj 1994), neni 15 dhe 17, lejon perdorimin e njesive dhe trupave te Ministrise se Puneve te Brendeshme ne detyra luftarake, si luftime ose rezistence te armatosur ne vecanti me rastin e deklarimit te gjendjes se luftes.
 - = 3) gjendja e luftes ishte deklaruar nga Qeveria Jugosllave me 24 Mars 1999.
 - = 4) nje rregullore mbi kompetencat e Puneve te Brendeshme gjate gjendjes se luftes (Gazeta Zyrtare e Republikes se Serbise, 7 Prill 1999), neni 8, lejon Ministrine e Brendshme te çvendose çdo punonjes te saj, ne interes te sherbimeve te kerkuara asaj.
 - = 5) Ligji i zakonshem mbi Punet e Brendshme, neni 38, parasheh ne nje Akt specifik mbi Organizimin dhe Sistematizimin ne Luftete Pozicioneve te Punes, se gjate gjendjes se luftes, njesite dhe postet mund te shkrihen dhe te grupohen se bashku, duke krijuar nje liste te re detyrash dhe plan vendosjeje.

Si rrjedhim, eshte e qarte se kompetencat e Momcilo Trajkoviq-it, nuk ishin te kufizuara ne ceshtjet administrative gjate kohes se luftes. Kompetencat ekzakte te te akuzuarit, njiheshin saktesisht prej popullit te zones se Kamenices. Eshte per tu shenuar fakti, se kur ata donin te kishin ndonje lajm per te afermit e tyre te zhdukur, ata venin direkt te Momcilo Trjkoviq, ne zyren e tij dhe disa here edhe ne shtepine e tij, dhe jo te Shefi i Policise (ne vecanti, H [redacted] Th [redacted] rreth zhdukjes se A [redacted] Th [redacted], N [redacted] K [redacted] dhe vellezerit e R [redacted] K [redacted] rreth zhdukjes se ketij te fundit, Z [redacted] J [redacted] rreth zhdukjes se vellait te tij E [redacted] J [redacted], sipas deshmise se dhene nga H [redacted] J [redacted]).

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trjakoviç/ Court decision

Number of pages:

Page 5 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Per me teper, ne perputhje me disa deshmi, i akuzuari ka vepruar personalisht ne pergatitjen ose ekzekutimin e disa krimeve.

Keshtu, R [REDACTED] M [REDACTED], i pyetur me 10.07.2000 prej gjykatesit hetues dhe me 08.12.2000 ne gjyq, ka percaktuar se me 23 Mars 1999, disa police te Kamenices erdhen ne shtepine e tij per te marre autobuzet e tij dhe makinen e tij "Mercedes", e cila u mor nga vete Momçilo Trajkoviç. Ay shton se, me 27 Prill 1999 ne Stacionin Policor te Kamenices, ay u pyet dhe u godit me grushta nga i akuzuari, i cili i tha atij ne gjuhen Serbe: "Serbet do te luftojne derisa te vdese edhe Shqiptari i fundit".

Deshmitari T [REDACTED] M [REDACTED], i degjuar nga Gjykata me 09.01.2001, percakton se ay ka pare Momçilo Trajkoviç me 09 Maj 1999 ne rrugen prane Bujanovcit, ne nje makine te zeze te markes "Golf", duke folur ne gjuhen Serbe me policet A [REDACTED] A [REDACTED] dhe K [REDACTED] ne lidhje me pergatitjen e nje plani aksioni. Ay shtoi se, pas 11 Maj-it, kur disa fshatra u rrethuan, ay gjeti nje liste me emrat e disa personave te vrare. Ne kete liste ishin te cituar ne veçanti emrat e R [REDACTED] L [REDACTED] dhe M [REDACTED] S [REDACTED], qe u vrane ne ate dite.

Keto elemente te ndryshem, formojne proven se Momcilo Trajkoviç, eshte personalisht pergjegjes per aktet kriminale te kryera ne zonen e Kamenices, kunder popullsise civile, por vetem per veprimet e organizuara dhe jo ato te izoluara.

IV

ESHTE FAJTOR

Per krimet e meposhtme, te kualifikuara si krime lufte nga Neni 142 i Kodit Penal te Jugosllavise ne perputhje me akt-akuzen e 21 Shtatorit 2000:

- Ne 1 Prill 1999, ne Kamanice, plagoset me arme zjarri M [REDACTED] R [REDACTED]. Arsyeya: viktima identifikon qelluesin, D [REDACTED], i cili deklaroi se e beri kete i urdheruar nga Momcilo Trajkoviç.
- Ne 11 Prill 1999 ne Kamenice, dogji shtepine dhe autobusin e H [REDACTED] R [REDACTED]. Arsyeya: disa ore me pare, Momcillo Trajkovic erdhi ne shkollen e drejtimit te automjetit dhe e kercenoj ate, se do ti vinte zjarrin shtepise dhe autobusit, nese ay nuk i ipte çelsat.
- Ne 17 Prill 1999 ne Kamenice, u plagos me arme zjarri Xh [REDACTED] L [REDACTED]. Arsyeya: nje prej qelluesve, i njohur me emrin Streqka, prej stacionit policor te Kamenices, u identifikua prej deshmitareve.
- Ne 17 Prill 1999 ne fshatin Krileve, u kidnapua dhe keqtrajtua H [REDACTED] D [REDACTED]. Arsyeya: viktima identifikoi dy police nga Kamenica, V [REDACTED] T [REDACTED] dhe N [REDACTED] T [REDACTED].

Job No.: Vendimi i Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trajkoviç/ Court decision

Number of pages:

Page 6 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

- Ne 18 Prill 1999, krijimi i panikut dhe terrorit si dhe perzenja e popullsisë civile nga fshatrat e Strezofcit, Leshtarit, Rahovices, Krileves dhe vrasja e A [redacted] M [redacted], A [redacted] I [redacted], Sh [redacted] I [redacted] dhe R [redacted] K [redacted]. Arsyeja: ishte nje aksion i planifikuar dhe organizuar, i kryer nga nje grup forcash, ne vecanti prej forcave policore.
- Ne 18 Prill 1999 ne fshatin Krileve, plagoset me arme zjarri Z [redacted] D [redacted], A [redacted] D [redacted] dhe B [redacted] S [redacted]. Arsyeja: aksioni u krye ne te njeten dite, ne vecanti nga forcat policore.
- Ne 19 Prill 1999, ne Petrovc, perzihet me force popullata civile, digjen shtepite dhe zhduken (dhe nuk vriten, sic percaktohet ne akt-akuze) M [redacted] Sh [redacted] dhe F [redacted] Sh [redacted]. Arsyeja: ishte nje aksion i planifikuar, i ndermarre prej forcave policore.
- Ne 4 Maj 1999 ne Kamenice, plagoset A [redacted] K [redacted]. Arsyeja: ky aksion u ndermore prej policeve te Kamenices, ne vecanti prej pese syresh, te identifikuar nga viktima.
- Ne 11 Maj 1999, rrethohen fshatrat Hogosht, Kopernice, Shishpanice, Kranidell, Karaqeva e Siperme, Karaqeva e Poshtme, Rogocice, Hodonovc, Topanice dhe Koretin, dhe me nje liste emrash te pergatitur me pare vriten R [redacted] L [redacted], M [redacted] S [redacted], I [redacted] I [redacted], N [redacted] K [redacted], A [redacted] Th [redacted]. Arsyeja: ishte nje aksion i planifikuar dhe organizuar, i ndermarre ne vecanti prej forcave policore, me listat e emrave te pergatitura qysh me pare.
- Ne 17 Maj 1999, ne fshatin Topanice dhe Kamenice, kidnapohet, keqtrajtohet dhe torturohet, R [redacted] M [redacted]. Arsyeja: keto akte u kryen nga policia e Kamenices, ne brendesi te stacionit policor.

Dhe per arsyet e pergjithshme te permendura me siper.

Keto krime do te kualifikohen si krime kunder njerezimit.

Arsyet:

Krimet e luftes kunder popullsisë civile:

Keto krime, te parashikuara nga Neni 142 i Kodit Penal te Jugosllavise, perfshijne sulmet kunder popullsisë civile gjate luftes ose konflikteve te armatosura, te cilat rezultojne ne vdekjen, demtimin e rende trupor, trajtimin çnjerezor ose çvendosjen e popujve.

Ky kualifikim nuk perfshin elementin thelbesor, karakteristike te konfliktit te shkaktuar ne Kosove: ekzistencen e sulmeve te perhapura dhe sitematike kunder popullsisë civile. Kjo rrethane eshte nje prej komponenteve te krimin kunder njerezimit, te percaktuar nga ligjet nderkombetare.

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit

Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trjaković/ Court decision

Number of pages:

Page 7 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Keshtu eshte e domozdoshme te kerkohet nese Neni 142, lejon te mbahen kunder te akuzuarit elementet e ketij krimi.

Krime kunder njerzimit:

Krimet kunder njerzimit jane shpjeguar ne menyre eksplicite ne Nenin 37, qe merret me krimet e denueshme me vdekje. Neni 37 par.4 citon midis ketyre krimeve "veprimet kriminale kunder njerzimit dhe te drejtes nderkombetare".

Nga ana tjeter, Neni 142 eshte i vendosur ne Kapitullin 16, te emertuar "Veprimet kriminale kunder njerzimit dhe te drejtes nderkombetare".

Pervec kesaj, Neni 142 i referohet "dhunimit te rregullave te se drejtes nderkombetare". Ligji nderkombetar nuk perfshin vetem tekstet nderkombetare mbi kodet e aplikueshme ose marveshjet nderkombetare, te nenshkruara rregullisht prej Shteteve te interesuara. Ay duhet te merret se pari, *si principe te pergjithshme te se drejtes nderkombetare* te njohur prej te gjitha kombeve.

Ky princip eshte shprehur ne "Nenin Martens" te vendosur ne Hyrjen e Konventes se II-te Hages, me 1899: "Derisa nje kod me i plote i ligjeve te luftes te realizohet, Palet e Larta Kontraktuese mendojne se eshte e drejte te deklarohet, se ne rastin e paperfshire ne Rregulloret e aprovuara prej tyre, popujt dhe luftenxitesit mbeten nen mbrojtjen e perandorise e principeve te se drejtes nderkombetare, siç ato rezultojne prej perdorimit te percaktuara midis kombeve te civilizuara, prej ligjeve te njerzimit dhe kerkesave te ndergjegjes publike".

Secila prej Konventave te Gjeneves te 1949-es per mbrojtjen e civileve gjate luftes, mbeshtetet ne Nenin Martens: I (neni 63), II (article62), III (neni 142), IV (neni 158). Kjo reference shfaqet gjithashtu ne nenin 1 te shteses se Protokollit I te 1977 dhe ne hyrjen e shteses se Protokollit II.

E drejta nderkombetare perfshin po ashtu edhe te Drejten Zakonore Nderkombetare. Neni 38 i Statutit te Gjykates Nderkombetare e Drejtesise, i vendosur ne Hage per te zgjidhur konfliktet midis shteteve, percakton keto rregulla ne vijim te: "Zakoni nderkombetar si evidence e nje praktike te pergjithshme te pranuar nga ligji". Ne perputhje me te Drejten Zakonore Nderkombetare, eshte e mundshme ti referohesh ne veçanti rregullave te perfshira ne *statusin* e Gjykatave Nderkombetare, po ashtu edhe *jurisprudences* se ketyre gjykatave.

Marreveshja e Londres e 8 Gushtit 1945 (neni 6 c), parasheh ekzistencen e krimit kunder njerzimit, po ashtu e parasheh kete edhe neni 10 i Ligjit te Keshillit te Kontrollit dhe statuti i Gjykates Ushtarake Nderkombetare te Nyrembergut. Statusi i Gjykates Nderkombetare te Tokios (neni 5 c) nenvizon gjithashtu ekzistencen e ketij krimi.

Job No.: Vendimi i M.Trajkoviçit

Translated by: Tritan Kalo

Phone: 7616

Description: Momcilo Trjakoviç/ Court decision

Number of pages:

Page 8 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Neni 5 i Statutit të Gjykatës Penale Nderkombetare për ish Jugosllavine (ICTY-GjPNJ), përfshin një përcaktim preciz të krimit kundër njerzimit, marrë për bazë edhe në nenin 7 të Statutit të Gjykatës së Ardhshme Penale Nderkombetare të krijuar nga Traktati i Romës i 17 Korrikut 1998; përben krim kundër njerzimit një prej akteve të përfshira po ashtu esencialisht në nenin 142 të Kodit Penal të Jugosllavise, kur ay kryhet brenda një "sulmi të gjere ose sistematik kundër çdo popullate civile, me njohurine e kryerjes së sulmit".

Në çështjen Tadiç, GjPNJ-ja përcaktoi kushtet e kerkuara për ekzistencën e krimit kundër njerzimit, duke analizuar në mënyrë precize konceptet e luftes ose të konfliktit të armatosur dhe të popullsisë civile, duke vendosur se një qëllim diskriminues kërkohej vetëm për krimet e persekutimeve raciale dhe duke vlersuar që, nëse të tjera kondita ndajshohen, edhe një akt i kryer për motive të pastra personale, mund të përbejë një krim kundër njerzimit (ICTY-GjPNJ Appeal Chamber, Tadiç, 15 July 1999, IT-94-1-T).

Në përputhje me Nenin 16 të Kushtetutës së Republikës Federative të Jugosllavise, kjo "rregulla përgjithsisht të pranuarë prej së drejte nderkombetare, duhet të jete pjesë përberese e rregullit ligjor të brendshëm".

Si rezultat i të gjithë këtyre elementeve, është e pershtatshme të vendoset se referenca në nenin 142 të Kodit Penal të Jugosllavise ndaj dhunimit të rregullave të së drejte nderkombetare, e ben të mundshme ngarkimin e autorit të akteve të përfshira në këtë tekst me krime kundër njerzimit, kur këto akte janë kryer brenda një plan sulmi të gjere ose sistematik kundër popullsisë civile.

Në përputhje me faktet e vena në pah me sipër, ka të dhena të mjaftueshme që Momçilo Trajkoviç ka kryer aktet, për të cilat është ngarkuar në kohën e luftes (të karakterizuara nga hyrja në konflikt të forcave të armatosura nderkombetare të NATO-s), kundër popullsisë civile si dhe me një plan të drejtuar, duke patur për qëllim mizorite sistematike ndaj tyre, për të cilat ay kishte njohuri të plote.

Si rezultat, është e domozdoshme të deklaroje të akuzuarin **fajtor për krime kundër njerzimit**, mbështetur në Nenin 142 të Kodit Penal të Jugosllavise.

V

DENIMI

Përcaktimi i denimit të krimeve kundër njerzimit

Është e domozdoshme të aplikohet shtesa e vitit 1990 e nenit 142.

Job No.: *Vendimi i M.Trajkoviçit* Translated by: *Tritan Kalo*

Phone: 7616

Description: *Momcilo Trajkoviç/ Court decision*

Number of pages:

Page 9 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Ne te vertete, Rregullorja 1999/24 percakton qe ligjet e aplikueshme ne Kosove jane ato, te cilat jane ne fuqi me 22 Mars 1999, por shton se ligjet pas vitit 1989 aplikohen, nese ato i adresohen nje çeshtjeje tashme te pa mbuluar (Pjesa 1.2), ose nese ato permbajne prerogativa me te favorshme per te inkriminuarin(Pjesa 1.4).

Neni i amenduar me 1990-en, parasheh 20 vjet burgim si denim maksimal. Eshte keshtu me e favorshme per te dyshuarin, sesa versioni i meparshem i te njetit tekst, i cili perfshin denimin me vdekje.

Ne te vertete, kur nje denim me i larte braktiset pa u zevendesuar, eshte e domozdoshme ti referohesh denimit te meposhtem kur kjo eshte e aplikueshme. Ne kete veshtrim, Neni 38 par.2 i Kodit Penal te Jugosllavise sakteson, qe gjykata mund te imponoj nje denim ose burgim prej 20 vjetesh, per nje akt te klasifikueshem per denimin me vdekje.

Ky nen nuk eshte veçanerisht i reapeluar prej Rregullores 1999/24, dhe nuk mund te konsiderohet si e inkluduar ne abolicionin e pergjithshem te denimit me vdekje prej kesaj Rregulloreje.

Ne te vertete, Neni 38 par.3, pa u lidhur me denimin me vdekje, eshte ende ne fuqi. Si nje perjashtim i Nenit 38 par.1, i cili parasheh nje denim maksimal prej 15 vjetesh burg, ky tekst lejon imponimin e 20 vjeteve burgim, per veprat e denueshme per nje periudhe 15 vjeçare, nese keto jane kryer me qellim dhe ne rrethane te veçanta renduese ose qe kane shkaktuar pasoja te renda, kur kjo parashikohet nga Ligji.

Keshtu, ky denim prej njezet vjetesh mund te imponohet per rastin e rende te plaçkitjes (Neni 141.2 KCK), aktet e renda speciale kunder sigurise se pergjithshme (Neni 164-3 KCK), fallsifikimi i parave ose fallsifikimi i letrave me vlere me pasoje demtimin e ekonomise kombetare (Neni 168-3 dhe 169-2 KCJ), rasti i rende i vjedhjes me arme ne zyra (Neni 177-2 KCJ), rasti i rende i rrembimit te nje avioni (Neni 240 KCJ) ose i demtimit te sigurise ne nje fluturim ajror (Neni 241-2 KPJ).

Si rrjedhim, teza e abrogimit te Nenit 38-2 mund te krijoj nje situatë paradoksale te permbyshjen e hierarkise se denimeve, per derisa nje denim maksimalisht me i lehte (15 vjet), mund te imponohet per krime me te renda.

Keshtu, eshte percaktuar qe 20 vjet burgim te jete tanime denimi, per autoret e krimeve te denueshme me vdekje.

Si vijim i kesaj, denimi i vene ne barre te akuzuarit eshte 20 vjet burg. Rendesa ekstreme e akteve te kryera, ne rrethanat e detajuara me pare, justifikojne denimin e Momçilo Trajkoviçit me maksimumin e ketij ndeshkimi.

Job No.: *Vendimi i M.Trajkoviçit* Translated by: *Tritan Kalo*

Phone:7616

Description: *Momçilo Trjakoviç/ Court decision*

Number of pages:

Page 10 of 12

Last time updated: 3/15/01

Created on 3/15/01 2:59 PM

Percaktimi i denimit per veprat e tjera

Per veprat e tjera, Gjykata percakton:

- per mbajtjen pa leje te armeve dhe te lendeve plasese, 4 muaj burg;
- per vrasjen ne tentative, 3 vjet burg.

Denimi i pergjithshem

Ne perputhje me nenin 42 te Kodit Penal te Jugosllavise, kur nje denim prej 20 vjetesh percaktohet per nje prej llojeve te krimit, vetem ky denim shpallet.

Keshtu qe, Gjykata denon Momcilo Trajkoviq me **20 vjet burg**.

Kjo kohe, perfshin periudhen e paraburgimit prej 7 Shtatorit 1999.

Burgimi i te akuzuarit duhet te vazhdoje per aq kohe, sa te merret nje tjetër vendim madhor, ne perputhje me nje vendim te veçante te bazuar ne nenin 353 par.1 dhe 6 te Kodit te Procedures Penale te Jugosllavise.

Gjykata vendosi konfiskimin e pushkes AK 47, te 300 fishekeve dhe dy granadave te dores, ne perputhje me nenin 69 te Kodit Penal te Jugosllavise.

Shpenzimet e procedures do te paguhen prej te akuzuarit.

Palet e demtuara mund te paraqesin kerkesen e tyre per demshperblim, ne nje gjykim te ri perpara nje Gjykate kompetente civile.

Per çka eshte thene me siper, eshte vendosur ne perputhje me pjesen pararendese te ketij akt-vendimi.

GJYKATA E QARKUT TE GJILANIT
ME 06.03.2001

Proçes-verbal mbajtesja
Igballe Azemi

Kryetari i Trupit Gjykses
Patrice de Charette



Informim juridik: Ju keni te drejten e apelimit kunder ketij vendimi ne Gjykatën Supreme te Kosoves, ne Prishtine, jo me vone se 15 dite pas marrjes se ketij vendimi. Ju duhet te beni dy kopje te ketij apelimi, te cilat do ti sillen nga ndermjetesi kesaj Gjykate.

Job No.: *Vendimi i M.Trajkoviçit* Translated by: *Tritan Kalo*

Phone: 7616

Description: *Momcilo Trjakoviç/ Court decision*

Number of pages:

Last time updated: *3/20/01*

Page 11 of 12

Created on *3/20/01 8:47 AM*